



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo



Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosova Council for the Cultural Heritage

Takim zyrtar me Z. Marten Menger, Sekretar i parë për politikë, protokoll, kulturë dhe informim në Ambasadën Gjermane në Prishtinë

E Marte, 28.02.2017

Më ftesë të Z.Marten Menger, Kryetari i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore i shoqëruar nga Isuf Koci, u.d. udhëheqës ekzekutiv, zhvilluan takim zyrtar në Ambasadën Gjermane në Prishtinë. Gjatë këtij takimi u bisedua për mundësit e bashkëpunimit për të gjitha çështjet që lidhen me trashëgiminë kulturore në Kosovë.

Kryetari i KKTK-së, falënderoj Ambasadën Gjermane për përkrahjen e vazhdueshme që kanë dhënë për Kosovën në të gjitha fushat, në veçanti në mbikëqyrjen e ligjeve që lidhen me mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

Gjithashtu u njoftua më sfidat që ka kaluar institucioni dhe të arriturat konkrete që janë bërë, konkretisht u njoftua më procesin e vlerësimit dhe shpalljes së njëzetetre (23) aseteve në mbrojtje të përhershme.

Z. Marten Menger, u shpreh se Ambasada Gjermane do të ofrojë përkrahje për Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore si institucion mjaft i rëndësishëm për trashëgiminë kulturore. Kërkojë nga kryetari i KKTK-së, që për të gjitha çështjet e mosrespektimeve ligjore të njoftohet edhe Ambasada, pasi që ne si Ambasadë bëjmë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve në Kosovë.